



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 02 Prot. Datë 14.05.2012

MINISTRIA E BRENDSHME

Nr. 58/17 Prot. Datë 13.06.2012

MINISTRIA E FINANCAVE

Nr. 124/9 Prot. Datë 10.9.2012

MINISTRIA E MBROJTJES

Nr. 06 Prot. Datë 25.6.2012

MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE
Nr. 5247 Prot. Datë 27.06.2012

UDHËZIM I PËRBASHKËT

“PËR PROCEDURAT E KONKURRIMIT PËR CAKTIMIN NË SEKSION TË PUNONJËSVE TË POLICISË GJYQËSORE”

Në mbështetje të paragrafit 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 10/a pika 2 të ligjit nr.8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, i ndryshuar, nenit 8 pika “gj” të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ligjit 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9069 datë 15.05.2003 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar,

U D H Ë Z O J M Ë :

Neni 1 Objekti

1. Ky udhëzim përcakton rregullat e procedurës së konkurrimit për:
 - a) Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që caktohen në seksionet e Policisë Gjyqësore nga Policia e Shtetit, në varësi administrative të Ministrisë së Brendshme;
 - b) Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që caktohen në seksionet e Policisë Gjyqësore nga Policia Ushtarake, në varësi administrative të Ministrisë së Mbrojtjes;

- c) Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që caktohen në seksionet e Policisë Gjyqësore nga njësitë e hetimit tatimor, në varësi administrative të Ministrisë së Financave;
- ç) Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që caktohen në seksionet e Policisë Gjyqësore nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (antikorrupsion), në varësi administrative të Ministrisë së Financave;
- d) Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që caktohen në seksionet e Policisë Gjyqësore nga Policia Pyjore, në varësi administrative të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

Neni 2

Caktimi në seksion

1. Caktimi i oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore të forcave policore, në seksionet e Policisë Gjyqësore, bëhet nga ministri që ka në kompetencë forcën policore që ligji i njeh të drejtën e ushtrimit të funksioneve të Policisë Gjyqësore, dhe me miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Caktimi i oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore në seksionet e Policisë Gjyqësore bëhet sipas sipas parashikimeve të nenit 10 të ligjit nr.8677 datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, (i ndryshuar), bazuar në një procedurë konkurrimi.

Neni 3

Rishikimi i organikës dhe vendet e lira

1. Prokurori i Përgjithshëm në bashkëpunim me ministrat që kanë në kompetencë forca policore që ushtrojnë funksionet e Policisë Gjyqësore, çdo dy vjet, rishikojnë organikat sipas parashikimeve të nenit 8 të ligjit nr.8677 datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, (i ndryshuar).
2. Kur lind nevoja e parashikimit të mbulimit të vendeve vakante, shpallja e vendeve vakante bëhet nga forca policore sipas kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm.
3. Shpallja e vendeve vakante botohet në dy gazetatat me qarkullim më të madh të paktën 30 ditë përpara datës së caktuar për konkurrim. Shpallja e vendeve vakante afishohet në një vend të dukshëm pranë strukturës më të lartë organizative në nivel vendor ku ndodhet pozicioni i lirë, si dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit përkatës.

Neni 4

Paraqitja e dokumentacionit

1. Dokumentacioni që dorëzohet nga kandidatët për oficerë ose agjentë të Policisë Gjyqësore pranë seksioneve përmban:
 - a) Kërkesën për t’u caktuar në seksionin e Policisë Gjyqësore duke treguar vendin që preferojnë;
 - b) Curriculum Vitae të detajuar;
 - c) Diplomën dhe listën e notave, të arsimit të lartë, të noterizuar, për kandidatët për oficer të Policisë Gjyqësore, dhe çdo dokument që plotëson kriterin e arsimit, sipas ligjit për forcën policore ku bën pjesë, për kandidatët për agjent të policisë gjyqësore;
 - ç) Librezën e punës;
 - d) Vlerësime të mëparshme të punës;
 - dh) Dëshmi të një gjuhe të huaj, të noterizuar (nëse ka);

